

**Drafti final**

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.A.**

**APLIKIM TARIFOR**

**DORËZUAR TE**

Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës (ZRRë)

Shkurt, 2008

## **Përmbajtja**

<b>1. Hyrje .....</b>	<b>3</b>
<b>2. Strategjia Tarifore .....</b>	<b>5</b>
<b>3. Të Hyrat e Lejuara .....</b>	<b>10</b>
<b>4. Përditësimi i Tarifave Ekzistuese .....</b>	<b>13</b>
<b>5. Amandamentet e Propozuara .....</b>	<b>21</b>
<b>6. Konsultimet .....</b>	<b>27</b>
<b>Tabela Raportuese 1: Tarifa Ekzistuese .....</b>	<b>28</b>
<b>Tabela Raportuese 2: Tarifa e Propozuar .....</b>	<b>29</b>

## 1. Hyrje

Aplikimi Tarifor i drejtohet Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) për aprovimin e tarifave të propozuara për Furnizuesin Publik dhe Rrjetin e Shpërndarjes të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Dokumenti përputhet me Udhëzimet e ZRRë-së për Aplikim Tarifor të miratuar nga ZRRë-ja me 27 Prill të vitit 2006. Tarifat e propozuara janë përgatitur në pajtueshmëri me Metodologjinë Tarifore të ZRRë-së, siç janë pranuar me 16 Janar të vitit 2007.

KEK-u e dorëzon këtë Aplikacion për vitin 2008 dhe propozon që këto tarifa të aprovohen nga ZRRë-ja dhe të hynë në fuqi me 1 Prill 2008. Aplikimi është përgatitur për:

- Ngarkesat për përdorimin e rrjetit shpërndarës (ngarkesa DUOS); dhe
- Ngarkesat e Furnizimit (tarifat e shitjeve me pakicë) për konsumatorët jo të privilegjuar, të kyçur në nivele të ndryshme të tensionit.

Tarifat e propozuara janë të dizajnuara që të mbulojnë "të Hyrat e Lejuara" të përcaktuara sipas formës së Modelit Tariforë të ZRRë-së duke përdorur vitin 2008 si vit provues. Modeli Tariforë jo vetëm që i llogarit të Hyrat e Lejuara, por pastaj bënë alokimin e kostos për secilën kategori tarifore dhe si përfundim llogaritë çmimet për secilën kategori. Në këtë Aplikim, KEK-u i përdorë si udhëzues, çmimet e nxjerra nga Modeli Tarifor, por propozon disa ndryshime në strukturën tarifore dhe çmime tjera për secilën kategori.

Rezultatet të nxjerra nga Modeli Tarifor për vitin 2008 tregojnë se të Hyrat e Lejuara për konsumatorët e zakonshëm në Kosovë dalin me shumën **153,741,000 (€)**.

Sipas Udhëzimeve për Aplikim Tarifor të ZRRë-së, Aplikimi përbëhet nga pesë seksione the dy tabela raportuese:

### Seksionet:

1. Strategjia Tarifore;
2. Të Hyrat e Lejuara;
3. Përditësimi i Tarifave Ekzistuese;
4. Ndryshimet e Propozuara; dhe
5. Konsultimet.

Tabelat Raportuese:

6. Tabela Raportuese 1: Tarifa Ekzistuese
7. Tabela Raportuese 2: Tarifat e Ndryshuara

KEK-u po ashtu dorëzon llogaritjet e të hyrave të lejuara siç është e përshkruar në modelin e Tabelës së Shqyrtimit Tariforë nga ZRrE-ja e që përfshinë:

1. Bilancin Energjetik;
2. Kostot e Blerjes së Energjisë;
3. Kostot e Mihjeve;
4. Kostot e Gjenerimit;
5. Kostot e Shpërndarjes;
6. Kostot Furnizimit; dhe
7. Kostot e Drejtorisë.

Modeli, i ZRrE-së, për Shqyrtimin Tariforë përmban dy fletë pune shtesë për llogaritjen e të Hyrave të Lejuara. Të dhënat për këto fletë pune janë përgjegjësi e KOSTT-it dhe përfshijnë:

1. KOSTT; dhe
2. Ngarkesat për TUOS/SO/MO.

## **2. Strategjia Tarifore**

Ky seksion paraqet evaluimin e tarifave të propozuara duke ju përshtatur kushteve të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë si dhe Metodologjisë Tarifore, në veçanti paraqet kërkesat për reflektimin e kostos dhe mos – diskriminimin ashtu siç kërkohet në atë metodologji. Metodologjia po ashtu kërkon një analizë të ngarkesave ekzistuese, veçanërisht të marrëdhënieve mes ngarkesave përkatëse të kategorive të ndryshme të konsumatorëve dhe kostos së furnizimit me energji elektrike të këtyre konsumatorëve.

Qëllimi i KEK-ut është që konsumatorëve të zakonshëm të ju ofrojë sasinë e tërë të energjisë elektrike që ata e kërkojnë dhe me tarifa të bazuara në kosto. Prandaj, strategjia për këtë Aplikim Tarifor të vitit 2008 është që të mundësojë burimet e domosdoshme për të ecur drejt këtij qëllimi.

KEK-u e pranon që, gjatë një të ardhme të afërt, ka kufizime të kapacitetit teknik në sistemin e rrjetit të transmisionit dhe në disa pjesë të rrjetit shpërndarës. Këto kufizime do të pengojnë KEK-un që t'i furnizojë konsumatorët me energji elektrike gjatë gjithë orëve të vitit. Megjithatë, KEK-u do të përpiqet që të operoj me sistemin e vet, duke minimizuar numrin e reduktimeve të energjisë për konsumatorët e zakonshëm.

Të Hyrat e Lejuara për tarifën e rregulluar ekzistuese të shitjeve me pakicë, të KEK-ut, përfundimisht u aprovuan nga ZRRE-ja më 31 Maj 2007 dhe kanë hyrë në fuqi më 1 Maj 2007. Tarifën e propozuara këtu janë kryesisht të bazuara në nivel të tensionit dhe kategorive tarifore. Duke u bazuar në analizat e kostove, elementet e tarifave të propozuara janë të ndara në ngarkesë fikse, në ngarkesë për fuqinë maksimale të angazhuar, ngarkesë të energjisë aktive dhe ngarkesës për energjinë reaktive. Tarifën po ashtu janë të bazuara në ndryshimin e shërbimit për secilën sezon (verë dhe dimër) dhe tarifën ditore për të gjithë konsumatorët, përveç konsumatorëve shtëpiak, (shiko seksionin 4 të këtij aplikacioni).

### **Tarifat e Furnizimit me Pakicë**

KEK-u mbështet idenë se tarifën për secilën kategori të konsumatorëve duhet të mbulojnë kostot në dhënien e shërbimeve dhe se, asnjëri prej konsumatorëve nuk

duhet të paguaj më shumë për energji elektrike se sa kostoja e krijuar nga KEK-u për shërbimin me energji elektrike. KEK-u po ashtu mbështet idenë që tarifat të mos jenë diskriminuese.

Tarifat, siç janë pranuar nga ZRrE-ja në aplikimin e më parëmë tariforë nuk reflektojnë në tërësi kostot por janë në pajtueshmëri me kërkesat për mos diskriminim. KEK-u pajtohet me këto parime dhe propozon që të lëvizet drejt tarifave të reflektuara më shumë nga kostoja, duke e ditur këtë një ndryshim i menjëhershëm në këto tarife do të rezultonte në një rritje të madhe për disa kategori të konsumatorëve.

Strukturat tarifore të përgjithshme të propozuara janë më transparente në aspektin e kostove ( të Hyrat e Lejuara) për grupe të caktuara të konsumatorëve. Tarifat e propozuara për secilin grup të konsumatorëve janë në përputhshmëri me kostot përkatëse të secilit grup duke përfshirë:

- Tarifën fikse;
- Tarifën e fuqisë maksimale (aty ku aplikohet);
- Tarifën e Energjisë; dhe
- Tarifën e Energjisë Reaktive (aty ku Aplikohet).

KEK-u e kupton rëndësinë e nevojës për mbrojtjen e konsumatorëve më të varfër në Kosovë dhe do të vazhdojë përpjekjet për këtë, por po ashtu e kupton se, roli i furnizuesit me energji elektrike nuk duhet të jetë sigurimi i beneficioneve sociale për konsumatorë të varfër. Qeveria e Kosovës prapë ka vendosur që të japë një subvencion për këta konsumatorë nga Buxheti Qendrorë, duke e ditur që kjo është një përgjegjësi e qeverisë e jo detyrë e një ndërmarrje me orientim komercial.

Modeli Tarifor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë ka përcaktuar që “Të Hyrat e Lejuara” të përgjithshme për KEK-në për vitin 2008 të jenë në vlerë prej **153,741,000** Euro, shumë kjo që kërkohet për të mbuluar kostot e shitjes së energjisë elektrike në përputhshmëri me metodologjinë e aprovuar tarifore.

Pasi që Qeveria pret nga KEK-u që të përmirësohet dhe të veproj si një entitet i shëndoshë komercial, KEK-u do të vazhdojë që të minimizojë humbjet dhe të ndërpresë shërbimin ndaj konsumatorëve të cilët nuk paguajnë. Si rezultat i kësaj e cila do të hynë në fuqi në vitin 2008, në se Qeveria nuk i transferon në mënyrë të veçantë e në

kohë, shumat që i ka premtua KEK-ut për Skemat e Mirëqenies Sociale, KEK-u rezervon të drejtën që t'i trajtoj të gjithë konsumatorët të barabartë, sipas Rregullores mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike dhe Rregullores për Shkyçje dhe Rikyçje të Konsumatorëve.

### **Tarifat e Rrjetit të Distribucionit. (DUOS)**

Gjatë llogaritjes së tarifave të veta, KEK-u bazohet në rregullat e Metodologjisë Tarifore dhe në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë. Tarifat e llogaritura pasqyrojnë kostot dhe nuk janë diskriminuese ashtu siç kërkohet në Metodologji. Këto parime janë shprehur në tarifat e ndryshme për nivele të ndryshme të tensionit në distribucion. Të hyrat e lejuara janë të alokuara për secilin grup tariforë duke përdorur faktorët (koeficientet) përkatës të alokimit për kostot e energjisë, fuqisë dhe të konsumatorit. Për më tej, tarifat kanë përdorur kostot marginale totale afatgjate të vlerësuara (LRMC) për nivelet e ndryshme të tensionit për të llogaritur nevojat e investimit dhe rritjen e kërkesës në të ardhmen për nivelet përkatëse të tensionit.

Tarifat DUOS përbëhen nga tarifa e energjisë dhe tarifa e fuqisë angazhuese. Tani për tani, nuk ka konsumatorë të privilegjuar aty ku kjo tarifë do të jetë e aplikueshme. Komponenti i tarifës së energjisë pasqyron koston e humbjeve përderisa komponenti i kapacitetit mbulon pjesën e ndryshuar të LRMC-s. Për konsumatorët pa matje të fuqisë, tarifa e kërkesës është e transformuar në tarifë të energjisë.

### **Klasifikimi i Kostove**

Në dizajnimin e tarifave të energjisë elektrike, kostot e shërbimeve janë bazë për këtë; çdo grup i konsumatorëve duhet të paguajë pjesën e tij të koston së përgjithshme për shërbimet e energjisë elektrike në të cilat hyjnë : kostoja e fuqisë, kostoja e energjisë dhe kostoja e konsumatorëve (fikse).

Kostot e fuqisë janë ato kosto që shkaktohen për të përmbushur kërkesat maksimale (kW) për konsumatorët në secilin nivel funksional të gjenerimit, të transmisioni dhe të shpërndarjes. Kjo nënkupton: dizajnimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës për të përmbushur ngarkesat maksimale të konsumatorëve në secilin nivel të tensionit.

Kostot e energjisë janë ato kosto që krijohen për të përmbushur kërkesat e energjisë (kWh) për konsumatorë, zakonisht kostot primare janë ato të derivateve dhe të blerjes së energjisë.

Kostot e konsumatorit janë ato kosto që krijohen për të përmbushur nevojat e shërbimeve të veçanta të konsumatorit siç janë: Matjet, leximet, faturimet, llogaritë e konsumatorit dhe shërbimin ndaj tij.

### **Tarifat e shitjeve me Pakicë**

Tarifat e shitjeve me pakicë për konsumatorët e fundit janë një kombinim i tarifës së furnizimit dhe tarifës DUOS. Secila nga tarifat e shitjeve me pakicë janë të përbëra nga elementet që pasqyrojnë kostot dhe e cila mund të matet, ose e cila përmban një ose më shumë klasë të kostove.

Tarifa e fuqisë maksimale për secilën kategori llogaritet si në vijim:

$$\text{Tarifa e fuqisë maksimale (€/kW)} = \frac{\text{Kostot që lidhen me fuqinë maksimale të alokuara ndaj grupeve të Konsumatorëve}}{\text{Totalin "e fuqisë maksimale të ngarkuar" për grup}}$$

Fuqia maksimale e ngarkuar është e rregulluar të jetë e barabartë me pikun e nivelit të tensionit për shkak të koston më të lartë për matjen dhe faturimin e fuqisë maksimale. Vetëm konsumatorët e mëdhenj i kanë njësorët për regjistrimin e kërkesës (maksigrafët). Për grupet e konsumatorëve pa njësorë të kërkesës, kostot e kërkesës janë të përfshira në tarifën e energjisë. (p.sh. kWh paraqet masën e ngarkesës).

Tarifa e energjisë është për secilën kategori llogaritur si në vijim:

$$\text{Tarifa e Energjisë (€/kWh)} = \frac{\text{Kostot në varësi të energjisë të alokuara ndaj grupit të Konsumatorëve}}{\text{kWh e konsumuar nga grupi i konsumatorëve}}$$

Kostot e konsumatorit janë të përfshira në tarifën fikse dhe janë llogaritur duke përdorur rezultatet e alokimit të kostos si vijon për secilin grup tarifor:

$$\text{Tarifa fikse (konsumatorët) (€/konsumatorë)} = \frac{\text{Kostot e konsumatorit të alokuar për grupin e konsumatorëve}}{\text{Numri i faturave vjetore të konsumatorëve për grup}}$$

Për konsumatorë të mëdhenj me matës adekuatë, tarifat e energjisë reaktive po ashtu janë të aplikueshme dhe faturohen si në vijim:

$$\text{Energjia reaktive (€/kVArh)} = \frac{\text{Kostot e energjisë reaktive të alokuara për grupe të konsumatorëve}}{\text{kVArh e konsumuar nga grupet e konsumatorëve.}}$$

### 3. Të Hyrat e Lejuara

Ky seksion jep rezultatet e llogaritjes së të Hyrave maksimale të lejuara që mbulohen nga Divizionet e Furnizimit dhe të Rrjetit të KEK-ut me ngarkesat e lejuara. Modeli Tarifor ka llogaritur se të Hyrat e Lejuara për konsumatorët e zakonshëm do të jenë **153,741,000 €**

Të hyrat e përgjithshme të lejuara të Divizioneve të Furnizimit dhe të Rrjetit në KEK janë llogaritur sipas Metodologjisë Tarifore të ZRrE-së dhe formës së Modelit Tariforë (modeli final 12 Shkurt 2008). Duke i përdorë të dhënat nga KEK-u, modeli llogaritë shumën e të hyrave që furnizuesi publik (Furnizimi i KEK-ut) dhe Rrjeti (Divizioni i Rrjetit në KEK) duhet ti mbulojnë përmes tarifave të shitjeve me pakicë që ju ngarkohen konsumatorëve jo të privilegjuar për furnizim me energji elektrike.

Kjo është e barabartë me shumën :

- E të hyrave të lejuara të furnizuesit publik, duke përfshirë energjinë elektrike të blerë nga gjenerimet e KEK-ut dhe nga importi;
- Tarifave për TUOS (tarifa e KOSTT-it) për mundësimin e shërbimeve të transmisionit për konsumatorët jo të privilegjuar; dhe
- Të hyrat e përgjithshme të lejuara të cilat Divizioni i Rrjetit në KEK (tarifat e DUOS për mundësimin e shërbimeve të distribucionit për konsumatorët e rregulluar).

Të Hyrat Lejuara janë të bazuara në vitin provues 2008. Viti provues 2008 është përdorur meqë tarifat e aprovuara finale nga ana e ZRrE-së në këtë aplikim do hyjnë në fuqi më 1 Prilli të vitit 2008. Të gjitha të dhënat e Modelit Tariforë (Balanci Energjetik, Kostot, etj.) janë të bazuara në vitin kalendarik 2008.


#### **Të Hyrat e Lejuara për Furnizim me Pakicë.**

Tabela në vijim paraqet të hyrat e përgjithshme të tarifave të pakicës që janë propozuar të inkasohen përmes tarifave të propozuara. Kjo tabelë është një përmbledhje e llogaritjeve të përfshira në Modelin Tariforë.

**Të Hyrat e Lejuara ('000 €)**

<b><u>Përshkrimi i Kostos</u></b>	<b>Mihjet</b>	<b>Gjenerimi</b>	<b>Rrjeti</b>	<b>Furnizimi</b>
<b>OPEX</b>	38,434.2	74,664.9	20,197.2	146,080.4
Mihjet/Mihjet+Gjenerimi		44,549.4	0.0	0.0
Gjenerimi Tjetër				0.0
Net OPEX	38,434.2	30,115.5	20,197.2	146,080.4
Pjesa e OPEX të Drejtorisë	3,478.4	1,576.1	1,660.2	529.8
<b>OPEX Totali</b>	41,912.6	31,691.6	21,857.4	146,610.2
Amortizimi	1,738.7	3,221.8	1,837.0	376.7
Kthimi	5,598.4	1,695.4	2,199.9	180.9
Blerja e Humbjeve	0.0	0.0	44,669.0	0.0
Rregullimi (8.2%)	0.0	0.0	0.0	0.0
SO/MO/TUOS	0.0	4,109.1	0.0	13,093.0
SO/MO/DUOS	0.0	0.0	0.0	58,258.3
Rregullimi Gradual	0.0	1,430.5	713.9	0.0
Kompenzimi dhe Rregullimi	-4,503.3	-160.3	-2,428.2	-480.4
Kompenzimi i Rregullimit të Humbjeve			-590.7	
Kufizimi në Furnizim (3%)	0.0	0.0	0.0	1,819.2
Rregullimi për Subvencionet e Pa-paguara				15,434.9
<b>Të Hyrat e Lejuara Bruto</b>				<b>235,292.8</b>
Shitjet e Pa-rregulluara				
Konsumatorët e Parregulluara				-19,807.1
Exportet				-1,461.9
Shitjet e Humbjeve				-50,282.8
Thëngjilli	-197.0			
Shitjet e përgjithshme të pa-rregul	-197.0	0.0	0.0	-71,551.8
Subvencionet e Blerjes së Derivatit	0.0	0.0	-10,000.0	-10,000.0

Diagrami në vijim paraqet se si kostot prej secilës fushë funksionale janë të përmbledhura në Shumën totale të Të Hyrave të Lejuara.



Mbesin dy çështje nga aplikimi i mëparshëm tarifor që KEK-u do dëshironte që ZRRE-ja ti merr parasysh siç janë: Arkëtimi dhe Borxhi i keq.

KEK-u vazhdon të përpiqet, në mënyra të ndryshme, për të përmirësuar arkëtimin , duke përfshirë të qenit më agresivë në shkyçjen e konsumatorëve për mos pagesë, adresimin e çështjeve të ndjeshme politike të enklavave, mbledhjen e borxheve të vjetra etj. Kur KEK-u do të përmirësojë shkallën e arkëtimin deri në një nivel të arsyeshëm, atëherë do të dëshironte që të trajtohet në mënyrë më të orientuar komerciale dhe të zvogëlojmë barrën ndaj BKK-së duke përfshirë në të hyrat e lejuara “Kostot nga Borxhet e Këqija”, sikurse është praktikë në ndërmarrjet komerciale në të gjithë botën. Secila kompani komerciale e cila i krediton konsumatorët ballafaqohen me shpenzime për shkak të borxheve të këqija, kjo ndodhë edhe me kompanitë me efikasitet më të lartë.

Çështja tjetër e kërkesës për të hyra, që është ngritur nga KEK-u në aplikimin e mëparshëm tarifor, është përcaktimi i “Kostove të Furnizimit”. Metodologjia tarifore specifikon se për përcaktimin e kostove të furnizimit duhet të përdoret një “Tepricë e Furnizimit” që bazohet në përqindjen e kostos së blerjes së energjisë elektrike (Kostot e Shitjes me Shumicë të Energjisë). Përqindja e mëparshme e përdorur nga ZRrE-ja për llogaritje të të hyrave të lejuara ka qenë 3%. KEK-u do të shqyrtojë kostot e tij si Furnizues Publik dhe do t’i dorëzojë rekomandimet e tij gjatë aplikimit të ardhshëm tariforë.

Furnizimi i KEK-ut i llogarit të hyrat e lejuara sipas Metodologjisë Tarifore. Ajo është shuma maksimale që i lejohet furnizuesit publik për t’i mbulua kostot nga ana e konsumatorëve jo të privilegjuar. Kjo përbëhet nga:

- Kostot e lejuara për blerjen e energjisë nga Gjenerimi i KEK-ut si dhe kostot e rrymës së importuar;
- Një tepricë e caktuar e barabartë me një përqindje të caktuar (3%) të kostove të lejuara për blerjen e energjisë; ashtu siç përshkruhet në Metodologjinë Tarifore; dhe
- Kostot e lejuara me pakicë për furnizimin e konsumatorëve të rregulluar (e barabartë me kostot e lejuara me pakicë për konsumatorë të shumëzuar me numrin e konsumatorëve të rregulluar).

#### **4. Përditësimi i Tarifave Ekzistuese**

Tarifat ekzistuese dhe të propozuara për secilin grup tarifor janë të dhëna në Tabelat gjegjëse: Tabela Raportuese 1 dhe Tabela Raportuese 2.

Me qëllim të zhvillimit të niveleve të çmimit dhe dizajnit të tarifave për tarifatat e propozuara, KEK-u e ka modifikuar modelin tarifor të ZRrE-s dhe ka bërë një Studim të Kostos së Shërbimit për të klasifikuar dhe për të alokuar të Hyrat e Lejuara për secilin grup të konsumatorëve. Kostot janë të klasifikuara si kosto fikse, variable dhe kosto të konsumatorëve. Të Hyrat e Lejuara më pas alokohen për secilin grup të konsumatorëve për të caktuar pjesën që i takon nga shuma e përgjithshme.

## Studimi i Alokimit të Kostos (së Shërbimit)

Gjatë studimit të kostos së shërbimit kemi përdorur faktorë të ndryshëm të alokimit për të alokuar secilin prej elementeve të kostos për grupin tariforë të konsumatorëve. Parimi i shkaktarit<sup>1</sup> të kostos është qasja tipike e përdorur për të zgjedhur alokimin adekuat për secilin prej elementeve të kostos.

Faktori i Alokimit	Emri	Përshkrimi	Kërkesat e të dhënave	Kostot e Alokua
1	Piku i Rastësishëm (PR)	Raporti, në përqindje, i kërkesës për secilin grup tarifor gjatë kohës së pikut të sistemit ndaj maksimumit të kërkesës së pikut.	1. Kërkesa e pikut të Sistemit 2. Kërkesa momentale e secilit grup gjatë kërkesës së pikut të sistemit.	Kostot fikse të përfshira në gjenerimin e energjisë elektrike.
2	Energjia (kWh)	Raporti, në përqindje, i shitjeve totale vjetore të energjisë të për secilin grup tariforë ndaj shitjeve të përgjithshme vjetore të sistemit.	1. Shitjet e energjisë për secilin grup të konsumatorëve. 2. Faktorët e humbjeve për secilin nivel të tensionit.	Kostot variabile të gjenerimit dhe kostot tjera variabile të furnizimit.
3	Piku jo i Rastësishëm (PJR)	Raporti, në përqindje, i kërkesës maksimale për secilin grup tarifor ndaj shumës së kërkesës maksimale të gjitha grupeve tarifore.	1. Kërkesa e pikut mesatar për secilin grup tarifor. 2. Shuma e kërkesave mesatare për të gjitha grupet tarifore.	Kosto fikse e përfshirë në rrejetë.
4	Konsumatorët	Raporti, në përqindje, i mesatares së numrit të përgjithshëm të konsumatorëve për secilin grup tarifor me shumën e mesatares së numrit të konsumatorëve për të gjitha grupet tarifore të konsumatorëve.	Mesatarja vjetore e numrit të konsumatorëve për secilin grup tarifor.	Pjesë e kostove që lidhen me konsumatorin.
5	Konsumatorët	Raporti, në përqindje, i	Kostot e njehsimit për	Një pjesë e kostos që

<sup>1</sup> Shkaktari i kostos zakonisht është principi qendror i alokimit të të gjitha kostove. Ky princip nënkupton se një kosto është alokuar në bazë të faktorit që e shkakton koston. Për shembull, një kompani shpërndarëse duhet të investoj në ndërtimin e kapacitetit të shpërndarjes për të përmbushur kërkesat e konsumatorëve gjatë pikut. Investimet në kapacitet korrespondojnë me kërkesën e pikut dhe kështu shkakton shpenzimet e investimit. Nëse e ndjek këtë, shpenzimi i investimit do të lejohet bazuar në disa matje të përgjithshme të pikut të grupeve të ndryshme të konsumatorëve ose kategorive të shërbimit. (Instituti i Kërkimeve të Rregullatorit Kombëtarë)


që posedojnë Grupe Matëse	numrit të përgjithshëm të konsumatorëve të mature të secilit grup tariforë me shumën e numrit të matur të konsumatorëve për të gjithë grupet tarifore të konsumatorëve. Kjo jep koston relative në mes grupeve tarifore për disa prej kostove që kanë të bëjnë me konsumatorin.	të gjitha grupet tarifore të konsumatorëve për të dhënë një përfaqësi të konsumatorëve të maturë. 1. 110 kV 2. 35 kV 3. 10 kV 4. 0.4 kV të mëdhenj 5. 0.4 kV TOD 6. 0.4 kV të vegjël (shtëpiak)	ka të bëjë me konsumatorin siç janë njehsimi dhe faturimi.
------------------------------	---	---	--

### **Procesi Tarifor**

Në zhvillimin e tarifave të propozuara, ky diagram paraqet procesin të cilin KEK-u rekomandon që të hiqet në të ardhmen..Procesi është konform Ligjit dhe Udhëzimeve të Metodologjisë Tarifore të ZRRë-së.

Rezultati nga ky proces do jetë që të ndajë (të shthurë) tarifat në mënyrë që të pasqyrojnë koston e furnizimit dhe kostot e rrjetit (transmisionin dhe shpërndarjen). Kur këto tarifa të jenë zhvilluar, atëherë, faturat e konsumatorëve mund të paraqesin shumat që janë të faturuara për secilin grup funksional. Tani, tarifa TUOS është e ndërtuar brenda tarifës së KEK-ut dhe nuk paraqitet si ndryshim i veçantë në faturën e Konsumatorit.

## PROCESI I DIZAJNIMIT TARIFOR TE KEK-të



### Përcaktuesit e Faturimit

Përcaktuesit e faturimit janë elemente tarifore që maten dhe për të cilat aplikohen çmimet për të llogaritur faturat e konsumatorëve. Përcaktuesit e faturimit përfshijnë:

- Ngarkesën fikse të konsumatorëve,
- ngarkesa fikse të kërkesës (kW), të energjisë (kWh), dhe, aty ku aplikohet, të energjisë reaktive (kVARh).

Modeli Tarifor vlerëson përcaktuesit e faturimit për secilën klasë të konsumatorëve bazuar në historikun e të dhënave të faturimit. Historiku i të dhënave përdoret për të llogaritur përqindjen e energjisë së faturuar në secilin bllok dhe pastaj aplikimi i këtyre përqindjeve në energjinë e përgjithshme të faturuar për secilën klasë të konsumatorëve në vitin 2008.

KEK-u ka mbledhur përcaktuesit e tanishëm të faturimit për vitin 2007 për secilin grup të konsumatorëve dhe i ka përdorur përcaktuesit e faturimit për vitin 2008.

## Përmbledhja e Përcaktuesve të faturimit të KEK-ut për 2007

Grupi Tariforë	Përcaktuesit e Faturimit	Gjithsejë
0 (110 kV)	Faturat e Konsumatorëve	
	KW	
	Verë kWh	
	Pikë	
	Jashtë pikut	
	Dimër kWh	
	Pikë	
	Jashtë pikut	
1 (35 kV)	Faturat e Konsumatorëve	
	KW	
	Verë kWh	
	Pikë	
	Jashtë pikut	
	Dimër kWh	
	Pikë	
	Jashtë pikut	
2 (10 kV)	Faturat e Konsumatorëve	
	KW	
	Verë kWh	
	Pikë	
	Jashtë pikut	
	Dimër kWh	
	Pikë	
	Jashtë pikut	
3 Kategoria I (0.4 kV)	Faturat e Konsumatorëve	
	KW	
	Verë kWh	
	Pikë	
	Jashtë pikut	
	Dimër kWh	
	Pikë	
	Jashtë pikut	
4 Kategoria II (0.4 kV)	Faturat e Konsumatorëve	
	KW	
	Verë kWh	
	Pikë	
	Jashtë pikut	
	Dimër kWh	
	Pikë	
	Jashtë pikut	

Grupi Tariforë	Përcaktuesit e Faturimit	Gjithsejë
5 Shtëpiak Njsorë 2 Tari	Faturat e Konsumatorëve	
	< 200 kWh	
	Verë kWh	
	Pikë	
	Jashtë pikut	
	Dimër kWh	
	Pikë	
	Jashtë pikut	
	200-600 kWh	
	Verë kWh	
	Pikë	
	Jashtë pikut	
	Dimër kWh	
	Pikë	
	Jashtë pikut	
	> 600 kWh	
Verë kWh		
Pikë		
Jashtë pikut		
Dimër kWh		
Pikë		
Jashtë pikut		
6 Shtëpiak Njesor 1 Tari	Faturat e Konsumatorëve	
	< 200 kWh	
	Verë kWh	
	Dimër kWh	
	200-600 kWh	
	Verë kWh	
	Dimër kWh	
	> 600 kWh	
Verë kWh		
Dimër kWh		
7 Shtëpiak të pamaturë	< 400 kWh	
	Faturat e Konsumatorëve	
	Verë kWh	
	Dimër kWh	
	400-800 kWh	
	Faturat e Konsumatorëve	
	Verë kWh	
	Dimër kWh	
	> 800 kWh	
	Faturat e Konsumatorëve	
Verë kWh		
Dimër kWh		
8 Ndriçimi publik	Faturat e Konsumatorëve	
	Gjithë kWh	

## Tarifat e Propozuara

Tarifat e reja mund të përcaktohen në disa mënyra të ndryshme. Modeli Tarifor i llogaritë tarifin duke u bazuar në alokimin e kostos së tij, disa prej të cilave përdorin koston marginale, dhe shumë supozime tjera.

Tradicionalisht, rritja e përgjithshme në tarifa përcaktohet, fillimisht duke përcaktuar rritjen në kërkesat e përgjithshme të të hyrave. Tabela në vijim jep këtë informatë. Të hyrat në tabelë janë llogaritur nga përcaktuesit e faturimit të përfshirë në Modelin Tariforë;

Të Hyrat e Lejuara të llogaritura në Modelin Tariforë janë si në vijim.

### Llogaritja e Rritjeve së Kërkuar e të Hyrave

<u>Kategoria Tarifore</u>		E Tanishme
<u>No.</u>	<u>Përshkrimi</u>	të Hyrat e Taifo
		<u>000 €</u>
0	110 kV	4,086.5
1	35 kV	1,495.6
2	10 kV	8,125.1
3	0.4 kV Kategoria I	8,766.0
4	0.4 kV Kategoria II	24,227.8
5	Shtëpiake 2 tarifore	61,485.2
6	Shtëpiake 1 tarifore	9,660.1
7	të pa Maturë	3,992.3
8	Ndriqimi Publik	672.3
		=====
	Të Hyrat e Përgjithëshme	<b>122,510.9</b>
<b>Të Hyrat e Përgjithëshme të Lejuara (l</b>		<b>153,741.0</b>
<u>Rritja e Kërkuarë</u>		
	Euro (000 €'s)	<b>31,230.1</b>
	Përqindja	<b>25.49%</b>

Modeli Tariforë për vitin 2008 siç është paraqitur në Tabelën Raportuese 2a, po ashtu paraqet përqindjen e ngritur që do të rezultonte për secilin Bllok përbrenda secilës kategori tarifore. Tabela 2b tregon rekomandimin tariforë për secilën kategori tarifore të KEK-ut. KEK-u bënë këto propozime që ndryshojnë nga rezultatet e modelit, duke arsyetuar si në vijim:

1. KEK-u beson se asnjëra nga tarifin përbrenda kategorive nuk duhet të zvogëlohet ashtu siç e paraqet rezultati i modelit. (shiko #3 për justifikim për këtë deklaratë);

2. KEK-u propozon që tarifat për konsumatorët shtëpiak të mos rriten menjëherë deri në nivelet e kostos së shërbimeve sepse një lëvizje e tillë do të shkaktonte një shokë të normës për ata konsumatorë; dhe
3. Futja e të dhënave për modelin përmbajnë shumë supozime që duhet të ekzaminohen nga ZRrE-ja dhe se KEK-u para aplikimit të ardhshëm tariforë beson se modeli i tanishëm përmban shumë supozime të gabueshme që nuk janë më të vlefshëm dhe se; këto supozime nxjerrin rezultate të pasakta. Për shembull, modeli nxjerr çmime për konsumatorët e Kategorisë 0 gjatë periudhës së ultë të verës që janë më të ulëta sesa kosto me të cilën KEK-u mund të prodhoj energji.

### **Të Ndryshme**

Më 23 Shkurt 2007, ZRrE-ja ka lëshuar “Njoftimin e Shkurtër” lidhur me aplikimin e KEK-ut për Tarifa. ZRrE-ja ka kuptuar se tarifat nuk kanë qenë tërësisht të bazuara në kosto por, po ashtu ka kuptuar se për të arritur atë nivel, ndikimi që do kishte kjo ndaj konsumatorëve individual, do të ishte shumë i madh. Letra thotë se “ Bordi i ZRrE-së i ka pranuar rekomandimet se tarifat e reja që pasqyrojnë koston duhet të bëhen kur vjen koha<sup>2</sup> ”. Aplikimi tariforë i KEK-ut këtu shkon drejt tarifave të cilat më shumë reflektojnë koston.

---

<sup>2</sup> Shiko Seksionin 5.1 të shkresës së raportit të ZRRE-së, të lëshuar më 23 Shkurt, 2007

## 5. Ndryshimet e Propozuara

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka propozuar disa ndryshime në strukturën tarifore të energjisë elektrike. Pritet që strukturat e propozuara tarifore, së bashku me çmimet e freskuara, do të hyjnë në fuqi me 01 Prill të vitit 2008.

Edhe pse të gjitha strukturat tarifore janë analizuar nga KEK-u, dy strukturat tarifore të adresuara këtu janë tarifat (Gjatë Ditës ) e lart dhe e ulët dhe Bllok Tarifa. Tarifat sezonale nuk janë adresuar këtu pasi që KEK-u beson që ndryshimet e kostos në mes periudhave të verës dhe dimrit janë të tilla që tarifat e shitjeve me pakicë janë të caktuara me vend për secilën sezon.

### **Tarifa Ditore (TD)**

#### ***Qëllimet:***

Strukturat e Tarifës Ditore zakonisht përdoren në tërë botën. Tradicionalisht tarifat ditore dizajnohen dhe zbatohen për dy qëllime kryesore të ndërlidhura mes veti.

1. Në shumicën e rasteve, kostoja e furnizuesit të energjisë elektrike është me e madhe gjatë furnizimit në kohën e pikut se sa në periudhat jashtë pikut. TD mundësojnë sinjale të duhura të çmimit për konsumatorët që: shfrytëzimi i energjinë elektrike gjatë periudhave të pikut kushton më shumë se sa gjatë periudhave jashtë pikut.
2. Tarifa Ditore po ashtu përdoret si një masë e menaxhimit të kërkesës dhe përdorë çmimet e caktuara të energjisë elektrike që t'i shtyjë konsumatorët që të kalojnë nga përdorimi i energjisë nga periudha e pikut në periudhën jashtë pikut. Me këtë përfitojnë të dy, edhe konsumatori dhe kompania. Lëvizja e ngarkesës nga periudha e pikut në periudhën jashtë pikut përmirëson faktorin ditor të ngarkesës në sistem me çka ju mundëson njësitë të gjenerimit që të punojnë në mënyrë më efektive me ngarkesë bazë. Kjo gjithashtu zvogëlon nevojat për blerjen e energjisë nga ndërmarrjet tjera me çmime të larta. Gjithashtu, edhe sistemi shpërndarës përfiton kur diagrami i ngarkesës ditore nuk përmban ngarkesa të larta maksimale (pique). Konsumatorët mund të përfitojnë duke i

zvogëluar faturat mujore duke shfrytëzuar çmimin e ulët gjatë periudhave të jashtë pikut.

Në shumicën e rasteve, Tarifat ditore të aprovuara nga rregullatorët përgatiten pas përfundimit të një procesi me kujdes të analizave. Këto analiza zakonisht përfshijnë një shqyrtim të ngarkesës së sistemit nga konsumatorët përmes diagrameve të ngarkesës. Pastaj, kostot për orë të punës së sistemit përdoren për të mundësuar informata të sakta për kostot për dizajnimin tariforë. Të dhënat e konsumatorëve dhe kontributi i tyre po ashtu përdoret për të vlerësuar premtimin e mundshëm nga konsumatorët për të paguar duke reflektuar ndryshimet në diagramin e ngarkesës (me këtë edhe të çmimeve më të ulëta). Kostot e zbatimit siç janë forma e re e njehsimit, modifikimet e faturimit dhe edukimi i konsumatorëve paraqesin gjithashtu një kontribut me rëndësi në programin e TD para zbatimit të saj. Pas fillimit të zbatimit të TD, është me rëndësi që të bëhet monitorimi dhe vlerësimi i suksesit të strukturës tarifore.

### ***Situata e Tanishme:***

Në Kosovë, gjashtë nga nëntë grupet tarifore i kanë strukturat e tarifës së ulët dhe të lartë. Konsumatorët përfitojnë nga faturat e ulëta të energjisë elektrike kur ata zhvendosin ngarkesën në periudhën jashtë pikut. Megjithatë, nuk është e qartë nëse KEK-u përfiton nga tarifa ditore.

Matjet e përdorimit të energjisë gjatë dhe jashtë pikut nuk duket të jetë e saktë dhe për këtë ka dy arsye:

E para, me reduktimet ditore, sipas programit ABC, njehsorët tariforë (kohorë) të konsumatorëve janë pa energji gjatë një ose më shumë orëve çdo ditë. Pa mbështetjen e duhur me bateri gjatë atyre periudhave, ora tarifore ndalet kur nuk ka rrymë. Me kthimin e furnizimit me energji, ora tarifore fillon aty ku ka ngecur. Prandaj, pas disa ditëve, ora tarifore nuk është në harmoni me kohën aktuale. Kjo rezulton me regjistrimin e energjisë së regjistruar gjatë kohëve të ndryshme me kohën aktuale (p.sh. përdorimi gjatë mesditës mund të paraqitet në njehsorë si e përdorur në mesnatë). Padyshim se kjo rezulton në leximet që nuk e reflektojnë me saktësi periudhën se kur është përdorur energjia, kështu që faturimi për periudhat e pikut dhe jashtë pikut nuk janë të sakta.

Konsumatorët në këtë tarifë mund të përfitojnë një faturë të ulët pa kaluar në përdorimin e energjisë në periudhat jashtë pikut.

E dyta, njehsorët e faturimit, dhe/ose reletë kohore, janë duke u manipuluar nga konsumatorët. Kjo është dëshmuar nga një numër i bllobave të thyera ose të humbura të releve kohore dhe njehsorëve të vërejtur nga lexuesit e KEK-ut. Konsumatorët shtëpiak janë kundërvajtësit kryesorë.

### **Bloku Tarifa (Grup Tarifa)**

#### ***Qëllimet:***

Bloku tarifave (ZRRë-ja i ka quajtur ato “banda tarifave”) janë përdorur në tërë botën për disa arsye. Në disa raste, pohohet se ato mundësojnë një sinjal më të mirë të çmimit ekonomik të konsumatorëve me kostot marginale të energjisë elektrike dhe përmes çmimit japin një nxitje që energjia elektrike të përdoret në mënyrë më efektive. Në raste tjera, bloku tarifave zbatohet për të dhënë energji elektrike me kosto më të ulët për konsumatorët që përdorin sasi të vogla të energjisë elektrike. Mendimi është që konsumatorët (e varfër) me të ardhura të vogla përdorin sasi të vogla të energjisë elektrike dhe se çmimi më i ulët në bllokun e parë mundëson një sasi minimale të energjisë elektrike që mund të përballohet. Zakonisht, në këtë rast, tarifa ka vetëm dy blloqe dhe nganjëherë quhet tarifa e “shpëtimit”. Blloku i parë (çmimi më i ulët) është i dizajnuar që të mundësojnë sasinë e energjisë elektrike që kërkohet nga një amvisëri tipike për t’i përmbushur nevojat e saj minimale (p.sh ndriçim dhe gatim). Në shumicën e rasteve, konsumatorët të cilët faturohen në tarifën e shpëtimit duhet të aplikojnë në ndërmarrje dhe të dorëzojnë dokumentacionin që tregon se ata i përmbushin kërkesat e konsumatorëve të varfër.

Ligji mbi Energjinë dhe ai mbi Rregullatorin e Energjisë mundësojnë që tarifave t’i japin ndihmesë konsumatorëve të varfër. Ligji qartë deklaron se të hyrat për këtë vijnë nga ndihmesat e tërthorta nga konsumatorët tjerë shtëpiak, jo nga konsumatorët komercial apo industrial.

### ***Situata e Tanishme:***

Në Kosovë, grupet tarifore numër 5 dhe numër 6 e kanë ndryshuar strukturën tarifore. Grupi 5 ndryshohet edhe më tutje për nga çmimet e TD dhe ato sezonale. Ndërsa, çmimet e Grupit 6 janë të ndara vetëm sipas sezoneve ( verë dhe dimër). Pasi që njehsorët nuk mund të masin sasi të energjisë elektrike të konsumuara për secilin bllok, atëherë faturat llogariten duke i marrë tarifën e përgjithshme të energjisë së përdorur gjatë kohës së pikut dhe jashtë pikut për t'i përdorur tarifën në secilin bllok.

### **Përshkrimi i Modifikimit të Grupit Tariforë**

#### **Grupi Tarifor 0 (110 kV)**

Nuk është propozuar asnjë ndryshim në strukturën tarifore. Njehsorët e rinj elektronik të kontrollit (kontrolli fillestar) janë në proces të prokurimit nga ana e KEK-ut; njehsorët e faturimit janë pronë e KOSTT-it.

#### **Grupi Tariforë 1 (35 kV)**

Nuk është propozuar asnjë ndryshim në strukturën tarifore. Njehsorët e rinj elektronik të faturimit janë në proces të prokurimit nga ana e KEK-ut.

#### **Grupi Tariforë 2 (10 kV)**

Nuk është propozuar asnjë ndryshim në strukturën tarifore. Njehsorët e rinj elektronik të faturimit janë në proces të prokurimit nga ana e KEK-ut.

#### **Grupi Tariforë 3 (Kategoria I – 0.4 kV)**

Nuk është propozuar asnjë ndryshim në strukturën tarifore. Njehsorët elektrik të faturimit janë në proces të prokurimit nga ana e KEK-ut.

#### **Grupi Tariforë 4 (Kategoria II – 0.4 kV)**

Tarifat Ditore janë ndërprerë; megjithatë struktura tarifore sezonale është ruajtur. Këta janë konsumatorë të vegjël komercial (dyqane, restorante etj.) që kanë pak mundësi për të bartur ngarkesën në periudhat jashtë pikut. Njehsimi i tanishëm nuk e regjistron me saktësi energjinë e përdorur sipas tarifave përkatëse për shkak të mungesës së mbështetjes me bateri për reletë kohore.

#### Grupi Tariforë 5 (Standard Shtëpiak)

Tarifa Ditore është ndërprerë; megjithatë struktura e tarifës stinore është ruajtur. Nuk është e qartë nëse ka ndodhur ndonjë lëvizje e ngarkesës si rezultat i tarifës ditore (të ulët dhe të lartë). Njehsimi i tanishëm nuk e regjistron me saktësi energjinë e përdorur sipas tarifave përkatëse për shkak të mungesës së mbështetjes me bateri për reletë kohore.

Struktura tarifore sipas blloqeve është ndryshuar nga tarifa me tri-bloqe në tarifë me një bllok dhe e ruan tarifën e konsumatorit.

#### Grupi Tariforë 6 (Shtëpiak të amvisërisë )

Struktura tarifore sipas blloqeve është ndërruar nga tarifa tri-bloqe në tarifë me dy-bloqe. Blloku i ri duhet të pasqyrojë një nivel adekuat të përdorimit të energjisë për të mbijetuar konsumatorët e varfër dhe duhet të jetë e përballueshme. Ky është një grup tarifor i amvisërisë . Me qëllim të kualifikimit për këtë tarifë, konsumatori duhet të aplikojë në KEK dhe të dëshmojë se i përket kategorisë së konsumatorëve të cenuar. Kjo qasje është në pajtueshmëri me legjislaturën vendore dhe udhëzimet e ZRrE-s për t'ju mundësuar mbështetje konsumatorëve të cenuar. Mungesa e të hyrave nga blloku i parë duhet të vijë nga konsumatorët e tjerë shtëpiak; ligji ndalon ndihmesën e tërthortë në mes klasave të konsumatorëve por e lejon atë brenda një klase tarifore.

KEK-u propozon të modifikojë strukturën tarifore për grupet tarifore 5 dhe 6 siç vijon:

<b>Grupi Tariforë No.</b>	<b>Elementi tarifor</b>	<b>Sezoni</b>	<b>Njësitë e Faturimit Mujor</b>
5	Tarifa fikse (e konsumatorit)	Gjithë muajt	€/konsumatorë
	Tarifa (kWh) e energjisë	Verë	€/kWh
	Tarifa (kWh) e energjisë	Dimër	€/kWh
	Tarifa fikse (e konsumatorit)	Gjithë muajt	€/konsumatorë
6	< tbd kWh	Verë	€/kWh
	> tbd kWh	Verë	€/kWh
	< tbd kWh	Dimër	€/kWh
	> tbd kWh	Dimër	€/kWh

#### Grupi Tariforë 7 (të Pamatur)

Pa ndryshime në Strukturën Tarifore.

#### Grupi Tariforë 8 (Ndriçimi Publik)

Pa Ndryshime në Strukturën Tarifore.

## 6. Konsultime

Përgatitja e këtij Aplikacioni për Tarifa është kryer pas analizave të thella të strukturës së kostove, kërkesave të bilancit energjetik, strukturës së mjeteve themelore dhe tarifore.

Ju lutemi shikoni tabelën e cila përmbledhë këto aktivitete.

Data(t)	Përshkrimi i Aktivitetit
3 Tetor 2007	ZRRE dhe KEK u takuan për të diskutuar Modelin Tariforë të përdorur në aplikimin e mëparshëm .
5 Tetor 2007	ERO dhe KEK u takuan për të diskutuar aplikimin tariforë dhe orarin.
10 Tetor 2007	ERO dërgoi KEK-ut njoftimin për Aplikimin Tariforë, Principet dhe orarin.
19 Tetor 2007	ERO dhe KEK- u takuan për të diskutuar aplikimin tariforë dhe orarin.
19 Tetor 2007	ERO I Dha KEK-ut Modelin Tariforë.
23 Tetor 2007	Në një Letër dërguar ZRRE-së, KEK-u ka dhënë informata sa i përket riorganizimit të Departamentit të Zyrës së Rregullatorit, procesit të ri të buxhetit, zhvillimit të ngarkesës dhe energjisë , parashikimit , çështjet e dizajnit tariforë, dhe modifikimi i kërkuar te ZRRE-ja për orarin e aplikimit tariforë.
1 Nëntor 2007	ZRRE-ja I përgjigjet letrës së KEK-ut, të 18 Tetorit 2007 dhe e ka korrigjuar aplikimin.
21 Nëntor 2007	ZRRE-ja dhe KEK-u janë takuar për të diskutuar statusin e aplikimit tariforë dhe orarin.
30 Nëntor 2007	ZRRE-ja ja dorëzoi KEK-ut, Modelin e Dytë Tariforë të korrigjuar.
7 Dhjetor 2007	KEK-u dhe stafi i ZRRE-së u takuan për të diskutuar Bilancin Energjetik dhe nevojën për një Plan Kontabël.
10 Dhjetor 2007	KEK-u i dha ZRRE-së draftin e Bilancit Energjetik për 2008, i cili nuk ishte aprovuar akoma nga Bordi i Drejtorëve të KEK-ut .
11 Dhjetor 2007	ZRRE dhe KEK u takuan për të diskutuar modelin tariforë dhe modifikimin e tij.
12 Dhjetor 2007	KEK ka kërkuar informata dhe qartësime për një numër artikujsh të përfshirë në Modelin Tariforë të ZRRE-së .
13 Dhjetor 2007	ZRRE e dërgoj përgjigjen ndaj kërkesës së KEK-ut, të 11 Dhjetorit 2007.
19 Dhjetor 2007?	KEK i dha ZRRE-së të dhënat e nxjerra informative për t'u futur në Modelin Tariforë.
19 Dhjetor 2007	ZRRE-ja ja dorëzoi KEK-ut Modelin e 3-të Tariforë të korrigjuar.
20 Dhjetor 2007	ZRRE-ja ka kërkuar informata shtesë nga KEK-u në të dhënat e dhëna për Modelin Tariforë.
Janar 2008	KEK-u e dorëzoi draft përgjigjen për draft pyetjet e ZRRE-së të 20 Dhjetorit 2007.
7 Janar 2008	ZRRE-ja e dorëzoi modelin e 4-të, të korrigjuar, të Modelit Tariforë te KEK-u.
23 Janar 2008	ZRRE-ja dhe KEK-u u takuan për të diskutuar pyetjet shtesë të ZRRE-së për të dhënat e KEK-ut të futur në Modelin Tariforë. Informata shtesë ishin kërkuar nga ZRRE-ja.
28 Janar 2008	KEK-u ja dorëzoi ZRRE-së Bilancin Përfundimtarë të Energjisë për 2007 dhe përgjigjet e korrigjuara me shkrim për pyetjet e ZRRE të 20 Dhjetorit 2007.
29 Janar 2008	KEK-u ja dorëzoi përgjigjet me shkrim për çështjet e ngritura gjatë takimit të 23 Janarit 2008 me KEK-un dhe ZRRE-në (çështjet janë përshkruar në rendin e ditës të ZRRE-së).
5 Shkurt 2008	KEK ka dorëzuar përgjigje shtesë te ZRRE-ja sa i përket një pjese të Modelit Tariforë.
8 Shkurt 2008	KEK është takuar me ZRRE-në për të diskutuar statusin e aplikimit tariforë dhe dokumentin e Aplikimit Tariforë final. ZRRE-ja ka kërkuar informacione shtesë të detajuara sa i përket CAPEX-it dhe kostos së importit.
12 Shkurt 2008	KEK-u takua me ZRRE-në për të diskutuar disa detaje të kostos në Modelin Tariforë. ZRRE-ja ka kërkuar informata shtesë nga KEK-u.
13 Shkurt 2008	Këshilltari i ZRRE-së i dha KEK-ut versionin e fundit të Modelit Tariforë, I cili përfshinte të gjitha modifikimet e bëra që janë diskutuar dhe pajtuar gjatë takimeve dhe korrespondencës në mes KEK-ut dhe ZRRE-së.
15 Shkurt 2008	KEK ka dorëzuar, te ZRRE-ja Aplikimin Final Tariforë.

## Tabela Raportuese 1: Tarifa Ekzistuese

### Tarifat e KEK-ut 2007

Grupi Tariforë	Kategoria e Furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia Faturuese	Koha e Ditës	Sezoni	
					Dimër	Verë
0	110 kV	Ngarkesa fikse	€/Vit			34.00
		Ngarkesa për fuqinë maksimale	€/kW			519.00
		Energjia Aktive	€/kWh	Lartë	6.03	1.78
		Energjia Reaktive	€/kWh	Ulët	2.50	1.47
1	35 kV	Ngarkesa fikse	€/Vit			30.00
		Ngarkesa për fuqinë maksimale	€/kW			540.00
		Energjia Aktive	€/kWh	Lartë	6.30	2.73
		Energjia Reaktive	€/kWh	Ulët	3.33	2.47
2	10 kV	Ngarkesa fikse	€/Vit			34.00
		Ngarkesa për fuqinë maksimale	€/kW			466.00
		Energjia Aktive	€/kWh	Lartë	7.07	3.15
		Energjia Reaktive	€/kWh	Ulët	3.81	2.87
3	0.4 kV Kategoria I	Ngarkesa fikse	€/Vit			29.00
		Ngarkesa për fuqinë maksimale	€/kW			270.00
		Energjia Aktive	€/kWh	Lartë	7.85	4.36
		Energjia Reaktive	€/kWh	Ulët	4.95	4.11
4	0.4 kV Kategoria II	Ngarkesa fikse	€/Vit			34.00
		Një Tarifë	€/kW			9.68
		Energjia Aktive (TOD)	€/kWh	Lartë	11.64	7.63
		Energjia Reaktive	€/kWh	Ulët	5.82	3.81
5	0.4 kV Shtëpiake Njësor 2 Tariforë	Ngarkesa fikse	€/Vit			24.00
		< 200 kWh (Blloku 1)	€/kWh	Lartë	4.42	3.17
			€/kWh	Ulët	2.21	1.58
		200-600 kWh (Bllok 2)	€/kWh	Lartë	5.97	4.28
			€/kWh	Ulët	2.99	2.14
		> 600 kWh (Blloku 3)	€/kWh	Lartë	8.67	6.21
6	0.4 kV Njësor 1 Tariforë	Ngarkesa fikse	€/Vit			24.00
		< 200 kWh (Blloku 1)	€/kWh		3.94	2.82
		200-600 kWh (Blloku 2)	€/kWh		5.32	3.81
		200-600 kWh (Blloku 2)	€/kWh		7.72	5.53
7	0.4 kV Shtëpiak të Pamatur	< 400 kWh/muaj	€/Muaj			20.00
		400-800 kWh/muaj	€/Muaj			36.00
		> 800 kWh/muaj	€/Muaj			61.00
8	Ndrçimi Publikë	Ngarkesa fikse	€/Vit			34.00
		Energjia Aktive	€/kWh		7.82	7.82

## Tabela Raportuese 2: Tarifa e Propozuar

### 2a. Tarifa e kalkuluar duke u mbështetur në Modelin Tarifor (versioni datës: 12 Shkurt 2008)

Grupi tarifor	Furnizimi i nivelit të Tensionit	Elementet Tarifore	Njësia	2008	
				Sezona Lartët	Sezona Ulët
				1 Tet - 31 Mar	1 Pr - 30 Shta
0	110kV	Ngargesa (fikse) e konsumatorit	€/customer/year	2671	
		Ngarkesa (kërkesa) fikse	€/kW	335	335
		Energjia Aktive (P), prej të cilave:	€/kWh	4	1.22
			€/kWh	1.69	1.02
Energjia Reaktive (Q)	€/kVArh	0	0		
1	35kV	Ngargesa (fikse) e konsumatorit	€/customer/year	352	
		Ngarkesa (kërkesa) fikse	€/kW	388	388
		Energjia Aktive (P), prej të cilave:	€/kWh	5.31	2.69
			€/kWh	3.14	2.51
Energjia Reaktive (Q)	€/kVArh	0.1	0.1		
2	10kV	Ngargesa (fikse) e konsumatorit	€/customer/year	148	
		Ngarkesa (kërkesa) fikse	€/kW	288	288
		Energjia Aktive (P), prej të cilave:	€/kWh	5.36	2.77
			€/kWh	3.21	2.58
Energjia Reaktive (Q)	€/kVArh	0.53	0.53		
3	0.4kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenjë të punëve)	Ngargesa (fikse) e konsumatorit	€/customer/year	81	
		Ngarkesa (kërkesa) fikse	€/kW	0	0
		Energjia Aktive (P), prej të cilave:	€/kWh	7.35	4.19
			€/kWh	4.73	3.96
Energjia Reaktive (Q)	€/kVArh	13.89	13.89		
4	0.4kV Kategoria II	Ngargesa (fikse) e konsumatorit	€/customer/year	76	
		Ngarkesa (kërkesa) fikse	€/kW	0	0
		Active energy (P)	€/kWh	6.26	4.02
		Energjia Aktive (P), prej të cilave:	€/kWh	6.38	4.02
€/kWh	6.38		4.02		
5	0.4kV (shtëpiak njëisorë 2-tariforë) (c)	Ngargesa (fikse) e konsumatorit	€/customer/year	65	
		<200kWh/muaj (First Block) prej të cilave:	€/kWh	6.18	4.5
			€/kWh	6.18	4.5
		200-600 kWh/muaj (Second Block) of which:	€/kWh	6.18	4.5
			€/kWh	6.18	4.5
		>600 kWh/month (Third Block) of which: (d)	€/kWh	6.18	4.5
€/kWh	6.18	4.5			
6	0.4kV (shtëpiak, njëisor 1-tariforë) (c)	Ngargesa (fikse) e konsumatorit	€/customer/year	55	
		<200kWh/muaj (First Block) prej të cilave:	€/kWh	6.18	4.5
			€/kWh	6.18	4.5
		>600 kWh/month (Third Block) of which: (d)	€/kWh	6.18	4.5
7	0.4kV (shtëpiak të pamaturë)	Konsumimi i Vlersuarë <400kWh/muaj	€/customer/month	26	
		Konsumimi i Vlersuarë 400-800kWh/muaj	€/customer/month	48	
		Konsumimi i Vlersuarë >800kWh/muaj	€/customer/month	116	
8	Ndrqimi Publik	Ngargesa (fikse) e konsumatorit	€/customer/year	55	
		€/kW	një tarifë	5.43	5.43

## 2b. Tarifat e Propozuara nga KEK-u

Grupi Tariforë	Niveli i Tensionit të Furnizimit	Elementi Tariforë	Njësia e Faturimit	Sezona			
				Dimër		Verë	
				Peak	Jash-peak	Peak	Jasht-peak
0	110 kV	Ngarkesa e Konsumatorit	€/Muaj	222.58			
		Ngargesa e Kërkesës	€/kW	520.00			
		Ngarkesa e energjis akti	€/kWh	6.70	3.00	2.00	1.75
		Ngarkesa e energjis rea	€/kVarh				
1	35 kV	Ngarkesa e Konsumatorit	€/Muaj	29.33			
		Ngarkesa e Kërkesës	€/kW	540.00			
		Ngarkesa e energjis akti	€/kWh	6.40	3.35	2.80	2.51
		Reactive energy charge	€/kVarh				
2	10 kV	Ngarkesa e Konsumatorit	€/Muaj	12.33			
		Ngargesa e Kërkesës	€/kW	466.00			
		Ngarkesa e energjis akti	€/kWh	7.90	4.00	3.25	2.95
		Reactive energy charge	€/kVarh	53.00		0.53	
3	0.4 kV Kategoria I	Ngarkesa e Konsumatorit	€/Muaj	6.75			
		Ngargesa e Kërkesës	€/kW	3.00			
		Ngarkesa e energjis akti	€/kWh	8.00	5.10	4.50	4.20
		Reactive energy charge	€/kVarh	1.55		1.55	
4	0.4 kV Kategori II	Customer Charge	€/Muaj	6.33			
		Ngargesa e Kërkesës	€/kW	0.00		0.00	
		Ngarkesa e energjis akti	€/kWh	11.70	6.00	7.90	4.00
5	0.4 kV Shtëpiak njësor 2- tariforë	Ngarkesa e Konsumatorit	€/Muaj	5.41			
		< 200 kWh	€/kWh	5.60	5.60	4.10	4.10
		200-600 kWh	€/kWh	5.60	5.60	4.10	4.10
		> 600 kWh	€/kWh	5.60	5.60	4.10	4.10
6	0.4 kV Shtëpiak njësorë 1- taiforë	Ngarkesa e Konsumatorit	€/Muaj	4.58			
		< 200 kWh	€/kWh	5.60		4.10	
		200-600 kWh	€/kWh	5.60		4.10	
		> 600 kWh	€/kWh	5.60		4.10	
7	0.4 kV Shtëpiak të pamaturë	< 400 kWh/Muaj	€/Muaj	26.00			
		400-800 kWh/Muaj	€/Muaj	48.00			
		> 800 kWh/Muaj	€/Muaj	116.00			
8	Ndriqimi Publik	Ngarkesa e Konsumatorit	€/Muaj	4.58			
		> 600 kWh/Muaj	€/kWh	5.43		5.43	